

VENDIM
Nr.43, datë 19.12.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	anëtar i “ “
Kristofor Peçi	anëtar i “ “
Kujtim Puto	anëtar i “ “
Petrit Plloçi	anëtar i “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 13.11.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.52 Akti, që i përket:

KËRKUES: BEG HAXHIU

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. PREFEKTI I QARKUT LEZHË, në mungesë.
2. ZYRA E PËRMBARIMIT LEZHË, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 44, datë 4.2.1997 të Gjykatës së Rrethit Kurbin.

Kërkuesi pretendon se është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi organet kompetente nuk kanë ekzekutuar vendimin e formës së prerë të gjykatës, duke passjellë mosrealizimin e të drejtës së tij të fituar gjyqësisht.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjorin, kërkuesin, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.44, datë 4.2.1997 Gjykata e Rrethit Kurbin ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit dhe detyrimin e të paditurit, këshillit të rrethit Kurbin, që t'i paguajë paditësit pagën në shumën prej 75125 lekësh.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr.2580, datë 6.11.1997, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur për t'i paguar paditësit pagën për periudhën 31.1.1996 deri më 30.9.1996, në shumën prej 135.975 lekësh.

Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësi.

Gjykata e Rrethit Kurbin, me vendimin nr.1, datë 5.1.1998, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin objekt shqyrtimi, mbi bazën e të cilit, Këshilli i Rrethit Kurbin detyrohet t'i paguajë paditësit pagën në shumën prej 135 975 lekësh. Mbi bazën e këtij vendimi, zyra e përmbarimit Lezhë ka nisur kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Kurbin.

Kërkuesi i është drejtuar me kërkesa të njëpasnjëshme si zyrës së përmbarimit, ashtu edhe prefekturës së qarkut Lezhë për ekzekutimin e detyrimit ndaj tij, por pa sukses. Nga dosja gjyqësore rezulton se zyra e përmbarimit Lezhë, e cila ishte kompetente për zbatimin e këtij urdhri, ka bërë disa përpjekje për ekzekutimin e këtij vendimi, të cilat gjithashtu kanë rezultuar të pasuksesshme. Kjo vërtetohet edhe nga shkresa nr.22/E prot., datë 4.5.2001 që zyra e përmbarimit Lezhë i ka dërguar degës së thesarit Lezhë, me anë të së cilës ajo urdhëron bërjen e ndalesave në llogarinë e prefekturës të shumës që kjo prefekturë i detyrohet kërkuesit si pasojë e vendimit gjyqësor objekt i këtij gjykimi.

Nga ana e prefekturës Lezhë, është kthyer përgjigje disa herë (shkresa më e fundit me nr.1427/1 prot., datë 2.11.2007) se është në pritje të akordimit të buxhetit shtesë dhe sapo të çelen fondet e Ministrisë së Brendshme, vendimi do të ekzekutohet menjëherë.

Duke qenë se gjatë gjithë kësaj kohe kërkuksi ka hasur në refuzimin e organeve kompetente për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, ai, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore të vëna në dispozicion për këtë qëllim, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të konstatuar cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e veprimeve të organeve të mësipërme.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuksi legjitimohet në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate dhe se pretendimet e tij për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor janë të bazuara.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme t'i referohet dispozitave konkrete procedurale, që parashikojnë ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore. Kështu, neni 589 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare ose në kredi që kanë te të tretët. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare e as kredi te të tretët, i kërkohej organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi, ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit. Ndërsa sipas nenit 591, ekzekutimi i detyrimeve të shtetit kryhet vetëm nëpërmjet bankës në kreditë e tij dhe te të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Duke iu referuar këtyre rregullimeve, rezulton se zyra e përmbarrimit Lezhë duhet të ekzekutojë, me të njëjtat mjete, detyrimin e debitorit ndaj kreditorit edhe, nëse debitori është një institucion buxhetor, ashtu siç vepron në rastet kur debitorë janë subjekte private.

Gjykata Kushtetuese, në rastin konkret, vlerëson se zyra e përmbarrimit ka ndërmarrë disa hapa konkrete procedurale për ekzekutimin e vendimit, por ka hasur në refuzimin e vazhdueshëm të debitorit, këshillit të rrethit e më pas prefekturës Kurbin, me arsyetimin se nuk ka fond buxhetor për këtë qëllim. Argumenti i paraqitur nga prefektura e qarkut Lezhë, lidhur me mungesën e fondeve, është i pamjaftueshëm dhe nuk justifikon mospagimin e detyrimit ndaj kërkuksit.

Në praktikën e saj të vazhdueshme, GJEDNJ-ja e ka konsideruar pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ-së të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm¹. GJEDNJ-ja vazhdimisht ka deklaruar se kërkuksit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga rezultati i favorshëm i procesit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit². Kjo Gjykatë ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej ineffektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Ashtu siç theksohet edhe në dokumente të njohura ndërkombëtare, zbatimi i plotë, efektiv dhe efikas i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetet me qëllim që të krijojnë, forcojnë dhe zhvillojnë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë³. Shteti i të drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet ose vendimet gjyqësore të formës së prerë⁴.

Në këtë linjë, Gjykata Kushtetuese ka pranuar tashmë në praktikën e saj se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës është

¹ Shih vendimin e GJEDNJ *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997; *Georgiadis kundër Greqisë*, 28 mars 2000.

² Shih çështjen *Burdov kundër Rusisë* nr.59498, 2002 dhe *Shilyayev kundër Rusisë* nr.9647/02, 6 tetor 2005.

³ Rezoluta e Konferencave të Ministrave Europianë të Drejtësisë, 4-5 tetor 2001. Marrë nga rekomandimi i Komitetit Europian për Bashkëpunim Ligjor, lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të vendeve anëtare të Këshillit të Europës.

⁴ Vendim i GJEDNJ *Hasan dhe Chaus kundër Bullgarisë*, nr.30985/96, faqe 87.

pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së¹.

Gjykata Kushtetuese konsideron me vend t'i referohet edhe një prej çështjeve me palë Shtetin Shqiptar të shqyrtuar nga GJEDNJ-ja, konkretisht rastin e Qufaj kundër Shqipërisë². GJEDNJ-ja ka theksuar se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mosrespektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta³, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, e garantuar nga neni 6/1⁴.

Gjykata Kushtetuese, nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuarit, për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet refuzimit, për moszbatim të vendimit të formës së prerë nga organet kompetente. Ajo vlerëson se në çështjen në shqyrtim pala debitorë i kishte të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim t'i paguante kërkuarit shumën që i detyrohej sipas këtij vendimi. Jo vetëm kaq, por gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata Kushtetuese nuk arriti të shohë asnjë veprim konkret të palës debitorë që do të tregonte sado pak vullnet për të ekzekutuar detyrimin që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Gjithashtu, edhe sa i përket organit të ngarkuar nga ligji me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pra, përmbartimit, Gjykata Kushtetuese çmon se ai duhet të kishte zbatuar me korrektësi dispozitat procedurale konkrete për këtë qëllim, pavarësisht faktit se debitor në këtë rast është një institucion buxhetor. Përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Kurbin ka sjellë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuarit të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.44, datë 4.2.1997 të Gjykatës së Rrethit Kurbin.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: V.Kristo.

Anëtarë: K.Peçi, Gj.Sauli, P.Plloçi, Xh.Zaganjori, K.Puto, F.Abdiu, S.Sadushi, S.Berberi.

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.6, datë 31.3.2006, përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (2007), faqe 65.

² Çështja *Qufaj kundër Shqipërisë*, 54268/00, 18 nëntor 2004.

³ Vendim i GJEDNJ *Romashov kundër Ukrainës* nr.67534, 27 korrik 2004; *Shvedov kundër Rusisë* nr.69306/01, 20 tetor 2005.

⁴ Shih edhe vendimin e kësaj Gjykate, *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997.